

**MBIJETESA E SHKOLLËS SHQIPE NË KOMUNËN E KAÇANIKUT
GJATË VITEVE 1989 - 1999**

**TEMA PËR TITULLIN
MASTER I HISTORISË – KOHA E RE**

**NGA
ZYLBEHAR LIKA**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË**

Dhjetor, 2022.

EKspoze e temës

MBIJETESA E SHKOLLËS SHQIPE NË KOMUNËN E KAÇANIKUT GJATË VITEVE 1989 – 1999

Menotor: Prof. Dr. Bujar Dugolli

Kandidati: Zylbehar Lika

Arsimi është shtylla kryesore e një shoqëri dhe nëse ajo rrënohet, rrënohet edhe ardhmëria e atij vendi, prandaj dhunën e shtetit serb mbi arsimin shqip në Kosovë duhet kuptuar si përpjeke shekullore për asimilimin e popullit shqiptar. Shqiptarët duke kuptuar rendësin e arsimimit në gjuhën shqipe, nuk u dorëzuan në asnjë moment para agresionit serb. Dhuna fizike, kërcënimet, ndalja e financimit, largimi i mësimit nga puna e nxënësve nga shkolla ishin format që përdori udhëheqja kriminale e Serbisë për t'i nënshtruar shqiptarët. Populli shqiptar i Kosovës, ndonëse në gjendje shumë të vështirë, gjeti rrugën më të mirë për t'i bërë ballë padrejtësive të regjimit të kohës, duke organizuar mësim për nxënësit në shtëpi-shkolla dhe vetëfinancim për mësimit në shtëpi.

Përmes sistemit “paralel” në Kosovë, u mbajt gjallë sistemi arsimor për nëntë vite me radhë. Pjesë e këtij sistemi ishte edhe organizimi i mësimit në shtëpi-shkolla për të mundësuar shkollim për të gjithë nxënësit shqiptar të dëbuar nga objektet shkollore. Ky fenomen i mësimit në shtëpi-shkolla ishte rast i veçantë, sepse nuk kishte raste të tilla në botë ku nxënësve iu mohojë e drejta e shkollimit, por ishte i domosdoshëm për ne si komb pasi që nuk kishim alternativë tjetër.

Në gjendje të vështirë gjatë kësaj kohe do të kaloj edhe Komuna e Kaçanikut, ashtu sikurse në vendet e tjera të Kosovës, edhe Kaçaniku do të jetë pjesë përpjekjeve për mbajtjen gjallë të sistemit arsimor, ku shumë familje nga këto treva do t'i shndërrojnë shtëpitë e tyre në shkolla, shumë mësimit do të keqtrajtohen nga organet policore serbe, e shumë e shumë të tjerë edhe pse në gjendje të rëndë ekonomike do t'i qëndrojnë besnik punës në arsim.

Gjatë punimit të kësaj teme kam kuptuar se ky organizim ishte i shkëlqyeshëm dhe me bindje mund të them se: vështirë që mund të gjendej ndonjë popull që do të mund të bënte një gjë të tillë më mirë se ne.

Për të qenë më i kuptueshëm, punimin e kam ndarë në pesë kapituj dhe në njësi më të vogla (tituj dhe nëntituj).

Kapitullin e parë do ta filloj me një historik të shkurtër të komunës së Kaçaniku. Kaçaniku si qendër administrative daton që nga fundi i shek. XVI, i cili deri në vitin 1891 ishte nahije e Sanxhakut të Shkupit në Vilajetin e Kosovës. Kaçaniku përfshin pjesën Juglindore të territorit të Kosovës. I rrethuar nga malet Rodope dhe mali Sharr, rrjedhja e dy lumenjve Lepec dhe Nerodime si dhe kalimi i hekurudhës Selanik-Fushë Kosovë dhe magjistrales Shkup-Prishtinë bënë që në Kaçanik të zhvillohen shumë veprimtari ekonomike si: bujqësia, blegtoria, tregtia dhe industria.

Në kapitullin e dytë kam trajtuar një nga periudhat më të rëndësishme të dekadës së fundit të shek. XX atë të organizimit të sistemit paralel, ku pjesa intelektuale e kohës, partitë politike dhe shoqëria në përgjithësi i themelojnë organet vetëqeverise të Republikës së Kosovës duke u bazuar në Deklaratën Kushtetues të 2 korrikut dhe në Kushtetutën e Kaçanikut. Kundër heqjes së autonomisë së Kosovës dhe tendencës së kthimit të popullit shqiptar në pozitën inferiore në shoqëri, mësimdhënësit dhe populli shqiptar reagoi përmes protestave dhe demonstratave anekënd Kosovës. Përmes këtyre organizimeve populli shqiptar i Kosovës shprehi vendosmërinë e palëkundur për të arritur lirinë e domosdoshme. Pjesë e këtyre përpjekjeve pa dyshim që ishte edhe organizimi i mësimin në shtëpi-shkolla, fenomen ky i përhapur anekënd Kosovës, sepse nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme në mënyrë të dhunshme ishin larguar nga objektet e tyre shkollore pasi që mësimdhënësit nuk pranuan të punonin me planprogramet e Serbisë. Me që tema është specifike për komunën e Kaçanikut, në kapitulli e III dhe IV të kësaj teme kam trajtuar organizimin e sistemit arsimor në Komunë e Kaçanikut gjatë periudhës 1990–1999. Të ndarë në kapituj janë shkollimi i mesëm dhe ai fillor në Komunën e Kaçanikut, ku secila shkollë përmban një historik më vete për këtë periudhë. Një rëndësi e veçantë iu kushtohet organizimit të mësimin në shtëpi-shkolla, ku përmes intervistave të realizuara me mësimdhënësit, literaturës së shfrytëzuar dhe dokumentacionit të siguruar nga arkivat, jam munduar të hedh sado pak dritë për këtë periudhë mjaftë të rëndësishme për Komunën e Kaçanikut.

Për të mbajtur gjallë shkollën shqipe, mësimdhënësit kishin shprehur vullnetin që të punonin pa pagesë, madje ata një gjë të tillë e bënë për një vit rresht.

Kapitulli V, iu kushtohet Këshillit Qendror të Financimit, dhe Këshillit Komunal të financimit në Kaçanik. Përmes organizimit të financimit u bë i mundur që të mbahej gjallë sistemi arsimor.

Sipas raporteve të Këshillit Qendror të Financimit, 90% e mjeteve të grumbulluara shkonin për arsimin, ku përfshihej paga për mësimdhënës dhe bursa për student si dhe shpenzime të tjera. Sipas këtyre raporteve kontribut të madh ka dhënë diaspora shqiptare.